



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Tiranë më, \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2021

**Lënda:** Kthim përgjigje.

**Z. V.K.**  
**BIRN ALBANIA**

**Për Dijeni: KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

**TIRANË**

I nderuar {...},

Duke shprehur konsideratën për Ju dhe median në të cilën ushtroni profesionin, në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar me numër rendor 23, datë 19.05.2021, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2249 Prot., datë 19.05.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për publikimin e regjistrimeve audio dhe procesverbaleve, **në çdo rast ka respektuar detyrimet ligjore**, që rrjedhin nga neni 69, i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Sa i përket kërkesës, për vënien në dispozicion të regjistrimeve audio dhe/ose procesverbaleve **të plota** të mbledhjeve së datave 16.01.2020, 28.09.2020, 19.10.2020 dhe 13.11.2020, siç kemi theksuar në shkresat e mëparshme drejtuar z. Karaj, veçanërisht në shkresën ezauruese pas seancës dëgjimore me Komisionerin **për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, se procedurat e verifikimit të kandidatëve të përmbushjes së kriterëve të figurës dhe të pasurisë, në kuadër të rekrutimit dhe ngritjes në detyrë, verifikimi përmban dhe të dhëna të klasifikuara “sekret shtetëror”, sikurse edhe të dhëna personale të kandidatëve, ndaj dhe KLGJ ka detyrimin ligjor për të kufizuar publikimin e këtyre regjistrimeve.

Ju ritheksojmë se jo vetëm për rastet për të cilët keni paraqitur kërkesë ju si media, **por në çdo procedurë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë**, legjislacioni në fuqi, neni 32 i Ligjit nr. 96/2016, parashikon marrjen e informacioneve nga disa institucione kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës të subjekteve. Konkretisht kërkohen ndër të tjera informacione nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, apo dhe shërbimet shtetërore informative, etj. Gjithashtu, sipas pikës 1, të nenit 45, të Kodit të Procedurave Administrative (KPrA), parashikohet se vetëm palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të

marrin kopje të tyre, në referim të pikës 3, të nenit 45, të këtij Kodi. Sa më sipër, referuar nenit 17 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dokumentet e kërkuara nga ana juaj, ndërsa përmbajnë të dhëna personale, tregtare dhe profesionale të gjyqtarëve/kandidatëve për gjyqtarë, nuk mund të vihen në dispozicion, të publikohen dhe të përdoren nga të tretë, pa pëlqimin e tyre. **Në këto kushte, KLGJ ka detyrimin ligjor për të kufizuar publikimin e procesverbaleve dhe regjistrimet audio.**

Veç sa më sipër, siç edhe ju jeni në dijeni, në respektim të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, rezultatet e verifikimit për kandidatët në përgjithësi **nuk mund të shqyrtohen në mbledhjet plenare të zhvilluara nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë**, në kushtet kur një mënyrë e tillë nuk garanton përmbushjen nga Këshilli të detyrimeve për mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave të klasifikuara “sekret shtetëror”, si dhe për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të kandidatëve, detyrime të cilat përcaktohen në këto ligje, por edhe në nenet 7 dhe 9, të Kodit të Procedurave Administrative. **Për këtë shkak, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit të kandidatëve në përgjithësi bëhet në mbledhje plenare që zhvillohen në ambientet/sallën e mbledhjeve të Këshillit dhe pa praninë e të tretëve.**

Ky qëndrim i mbajtur nga KLGJ është bazuar në udhëzimet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) e cila ka theksuar në shkresën saj nr. 808, datë 09.04.2020, adresuar KLGJ, se informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror” duhet të përpunohen, administrohen, qarkullohen dhe transmetohen vetëm nëpërmjet mjeteve, platformave, pajisjeve dhe rrjeteve të certifikuara përshtatshëmish më parë nga DSIK-ja, si dhe *në kushtet e punës në distancë është rreptësisht e ndaluar aksesimi, përdorimi, ndarja, qarkullimi dhe administrimi i informacionit të klasifikuar duke përdorur internetin.*

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, informojmë se më datë 12.03.2020, Këshilli vendosi pezullimin e organizimit dhe zhvillimit të mbledhjeve plenare në ambientet e selisë së tij. Kjo situatë vijoi deri më datë 22.04.2020, kur Këshilli vendosi rifillimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me Rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Pas kësaj date, zhvillimi i mbledhjeve plenare në **sallën e Këshillit** ka qenë i pamundur në kushtet kur parametrat e saj nuk garantonin respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19. **Në fund të Korrikut 2020, selia e Këshillit u zhvendos në një godinë tjetër.** Në Shtator 2020, Këshilli filloi zhvillimin e mbledhjeve plenare **në një sallë** e cila, ndonëse **garanton distancimin social**, në rast të pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve, njëkohësisht, në mbledhje plenare (organ kolegjal në përbërje të tij 11 anëtarë), **por që nuk garantonte** përmbushjen nga Këshilli të detyrimeve për mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave të klasifikuara “sekret shtetëror”, si dhe për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të kandidatëve. **Ndërkohë që salla e cila është planifikuar për zhvillimin e mbledhjeve plenare të KLGJ, ndonëse garantonte regjistrimin audio pasi është desinfekuar sipas procedurave të ligjore për trajtimin e informacionin të klasifikuar, nuk siguronte distancimin social, rregull i vendosur në kushtet e pandemisë.**

Ndodhur në këto kushte, në mbledhjen plenare të Këshillit të datës 17.09.2020, nga ana e anëtarëve është diskutuar lidhur me mënyrën e vijimit e verifikimit të kandidatëve që garojnë/kandidojnë në procese të ndryshme të nisura nga KLGJ. Nga ana e anëtarëve është dakordësuar të vijohet me shqyrtimit e materialeve lidhur me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve në sallën që ndonëse mundëson distancimin social, nuk garanton sigurinë e informacionit, ndaj për këtë shkak por në kushtet kur nuk garantohet siguria e informacionit, **të mos bëhet regjistrim audio i mbledhjes**. Pra ka një qëndrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të zhvilluar mbledhjet plenare të tij, duke shqyrtuar materiale lidhur me verifikimin e kandidatëve, në sallën e cila nuk garanton sigurinë e informacioni, pa regjistrim audio të këtyre seancave. Për më tepër linku: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/10/MBLEDHJE-E-KLGJ-s%C3%AB-Dat%C3%ABs-17.09.2020-mledhja-2-1.pdf>

Vlen të saktësohet procesi i përzgjedhjes, deri në vendimin për propozimin Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, kalon nëpër disa faza të përcaktuara hollësisht në aktet nënligjore të miratuara nga KLGJ. Procedura e përzgjedhjes për z. Darjel Sina, ende nuk e ka kaluar fazën e dëgjësës publike, në të cilën ftohen palët e treta, përfshirë edhe mediat. Kjo fazë shqyrtimi shpërben jo vetëm për të parashtruar platformën, por i jep të drejtën anëtarëve të Këshillit të shtrojnë pyetje rreth çdo aspekti profesional, etik dhe moral.

Vlerësojmë se KLGJ, bazuar në informacionin shterues të dhënë në këtë shkresë, si dhe në shkresat e mëparshme, në drejtim të z. Karaj, është korrekt si në të drejtën tij për tu informuar ashtu dhe në mbrojtjen e interesave të ligjshme të subjekteve pjesëmarrëse në procedura administrative të organizuara.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,